

Në bazë të nenit 95 pika 3 e Kushtetutës së Malit të Zi, miratoj

Dekretin mbi shpalljen e ligjit “Për lëndët plasëse”

Shpall ligjin “Për lëndët plasëse”, të miratuar nga Kuvendi i Malit të Zi në mbledhjen e shtatë të seancës së parë të rregullt të vitit 2008, datë 29 korrik 2008.

Numër: 01-1552/2

Podgoricë, 4 gusht 2008

Presidenti i Malit të Zi
Filip Vujanović, d.v.

Ligji “Për lëndët plasëse”

*Ligji është publikuar në “Fletoren Zyrtare të MZ”, nr. 49/2008 datë
15.8.2008 dhe [58/2008](#).*

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj parashikohen kushtet për prodhimin, tregtinë, prokurimin, ruajtjen dhe përdorimin e lëndëve plasëse për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës, si dhe çështje me rëndësi për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Përfundim

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për prodhimin, tregtinë, remontin, mirëmbajtjen dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për nevoja të ushtrisë së Malit të Zi, për ruajtjen e lëndëve plasëse në magazinat minatore të shoqërive tregtare dhe personave të tjerë juridikë në fushën e minierave dhe nevojën e përdorimit të këtyre lëndëve në miniera, si dhe për raste të tjera në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare.

+

Korrigjimi - 58/2008-8.

Shih:

Llojet dhe përkufizimi i lëndëve plasëse

Neni 3

Lëndët plasëse, në përmbajtje të këtij ligji, janë lëndët kimike të ngurta dhe të lëngshme, tipari i të cilave është që nën efektin e përshtatshëm të jashtëm (goditje ose fërkim), nëpërmjet zbrërimit plasës kimik, të çlirojnë energji në formë nxehtësie ose gazi.

Lëndët plasëse të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 1) lëndët plasëse për qëllime shitje;
- 2) pajisjet për ndezjen e plasësit;
- 3) pajisjet piroteknike;
- 4) municioni për qëllime shitje;
- 5) baruti;
- 6) produktet të mbushura me lëndë plasëse;
- 7) lëndët e para të karakterit plasës për prodhimin e lëndëve sipas pikave 1 deri 6 të këtij paragrafi.

Lëndët plasëse për qëllime shitje janë lëndët të cilat përdoren për shkatërrimin dhe formësimin e objekteve dhe materialit nëpërmjet energjisë së çliruar nga reaksioni kimik i zbrërimit shpërthyes.

Mjetet për ndezjen e plasësit janë kapsollat e të gjitha llojeve, ndezësit, siguresat dhe pajisjet teknike të cilat përdoren para minimit.

Pajisjet piroteknike janë pajisje të cilat përdoren për fishekzjarrët, raketat kundër breshërit dhe raketat e tjera që përdoren për qëllime shkencore, tregtare dhe qëllime të tjera, si dhe objektet të cilat përmbajnë përbërës kërcitës me veprim plasës ose përbërës të tjerë të cilët shërbejnë për arritjen e efektit të zjarrit, dritës, plasjes dhe tymit.

Municione për qëllime tregtare janë plumbat, fishekët dhe gëzhojat e përgatitura me kapsolla dhe të

mbushura me barut.

Barutet janë lëndët plasëse të cilat digjen nëpërmjet përqeshmërisë së nxehtësisë dhe kryesisht janë të destinuara për të hedhur predhën, dhe ndahen në barute të zinj dhe me pak tym.

Produktet e mbushura me lëndë plasëse janë lëndët të cilat janë mbushur me përzierës plasës dhe/ose piroteknik, efekti i të cilave varet prej këtyre lëndëve.

Lëndët e para me karakter plasës janë lëndët të cilat sipas përbërjes kimike dhe ndjeshmërisë ndaj ndezjes kanë tiparet e plasësit dhe janë në gjendje për shpërbërje plasëse, ndërsa janë të destinuara për prodhimin e lëndëve plasëse.

Zbatimi i përshtatshëm i rregullave të procedurës së përgjithshme administrative

Neni 4

Ndaj procedurave të parashikuara me këtë ligj zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin është rregulluar procedura e përgjithshme administrative, në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Përkufizime të termave

Neni 5

Terma të caktuar të përdorur në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1) **riciklim (demontim)** është ripërdorimi i lëndëve plasëse në qëllime të tjera pas heqjes së lëndëve plasëse nga municionet dhe pajisjet mino-plasëse;

2) **neutralizim** është ndryshimi kimik i lëndës plasëse në lëndë joplasëse;

3) **asgjësim i lëndës plasëse** është asgjësimi i plotë i lëndës plasëse nëpërmjet djegies, detonimit ose nëpërmjet procedurave të tjera;

4) **furnizues** është prodhuesi, përfaqësuesi i tij me seli në Malin e Zi, importuesi, respektivisht shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës i cili ka vendosur lëndën plasëse në qarkullim ose ka mundësuar shfrytëzimin e saj;

5) **përdorimi** është përgatitja direkte dhe aktivizimi i lëndëve plasëse;

6) **administrim** nënkupton veprimet që kryejnë personat fizikë gjatë prodhimit, testimit, ruajtjes, qarkullimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse, të cilat plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj ;

7) **person përgjegjës** është personi fizik në shoqërinë tregtare, në person tjetër juridik ose tek sipërmarrësi, i cili është përgjegjës për procesin e prodhimit, testimit, qarkullimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse, në përputhje me këtë ligj;

8) **ruajtje** është mbajtja dhe ruajtja e lëndëve plasëse në objektet për prodhim dhe ruajtje, në magazina dhe kontejnerë;

9) **objekt prodhues** është objekti i ndërtuar dhe i kontrolluar me hapësirën përkatëse, i cili është i destinuar për prodhimin e lëndëve plasëse dhe i ndërtuar dhe pajisur në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e jetës, shëndetit dhe siguria e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës;

10) **objekt i magazinimit** është objekti i ndërtuar dhe i kontrolluar me hapësirën përkatëse, i cili është i destinuar për magazinimin, ngarkimin ose shkarkimin e lëndëve plasëse, i ndërtuar dhe i pajisur në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e jetës, shëndetit dhe siguria e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës ;

11) **magazinë** është ambienti për vendosjen e municionit, barutit të gjuetisë, kapsollave për municion gjuajtës, pajisjeve piroteknike, siguresat me djegie të ngadalshme dhe mjetet ndihmëse për ndezje, me kushtin që sasia e përgjithshme e barutit, përfshirë edhe barutin edhe municionin, nuk e kalon sasinë prej 20 kg ose 150 kg bruto të pajisjeve teknike;

12) **kontejner** është arka transmetuese ose e transportit për ruajtjen e lëndëve plasëse.

II. MASAT E SIGURISË

Masat parandaluese dhe mbrojtëse

Neni 6

Gjatë prodhimit, testimit, transportit, përdorimit, ruajtjes, riciklimit (demontimit), neutralizimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse, shoqëritë tregtare, personat e tjerë juridikë dhe sipërmarrësit, janë të detyruar që të kujdesen për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve e bimëve, mjedisit dhe pronës dhe të zbatojnë masat e përcaktuara me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij dhe rregullat për rregullimin e mbrojtjes dhe shpëtimit, mbrojtjen në punë, mbrojtjen shëndetësore, mbrojtjen e ambientit jetësor, planifikimin dhe rregullimin e ambientit dhe ndërtimin e objekteve.

Mënyra e zbatimit të masave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni rregullohet me aktin e përgjithshëm të shoqërisë tregtare, të personit tjetër juridik dhe sipërmarrësit.

Neni 7

Shoqëritë tregtare, personat e tjerë juridikë dhe sipërmarrësit të cilët merren me prodhimin, testimin, tregtimin, përdorimin, ruajtjen, riciklimin (demontrimin), neutralizimin dhe asgjësimin, janë të detyruar që personat të cilët administrojnë lëndët plasëse ose kryejnë veprime të tjera në lidhje me lëndët plasëse, të njihen me masat e përcaktuara me aktet sipas nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, si dhe t'i kualifikojë ata për veprimet në rast aksidenti tekniko-teknologjik ose të një aksidenti tjetër, në përmbajtje të aktit nënligjor për mbrojtjen dhe shpëtimin.

Mbrojtja fizike dhe teknike e objekteve

Neni 8

Objektet në të cilat kryhet prodhimi ose ruajtja e lëndëve plasëse duhet të jenë nën ruajtje të përhershme fizike dhe teknike, në përputhje me ligjin e posaçëm.

Organizimi dhe kontrolli i masave të parashikuara të mbrojtjes

Neni 9

Shoqëritë tregtare, personat e tjerë juridikë dhe sipërmarrësit e përmendur në nenin 7 të këtij ligji, janë të detyruar të organizojnë dhe kontrollojnë zbatimin e masave mbrojtëse, në përputhje me ligjin.

Masat në rast humbje

Neni 10

Shoqëritë tregtare, personat e tjerë juridikë dhe sipërmarrësit e përmendur në nenin 7 të këtij ligji, janë të detyruar që për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse, menjëherë dhe jo më vonë se një orë pasi është vënë në dijeni, të njoftojnë ministrinë kompetente për punët e brendshme (më tej në tekst referuar si: Ministria) dhe organin kompetent për çështjet e policisë.

Zona e rrezikshmërisë

Neni 11

Në zonat që kërcënojnë objekte nga neni 8 i këtij ligji, nuk mund të lejohet ndërtimi i objekteve të tjera përveç atyre që shërbejnë për sigurimin e këtyre objekteve.

Kufijtë e zonave nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.

III. KUSHTET PËR PRODHIM, TREGTIM, PROKURIM DHE PËRDORIM

1. Kushtet teknike dhe procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë

Autorizimi për vënien në treg

Neni 12

Lënda plasëse mund të vendoset në treg dhe në përdorim vetëm në qoftë se ka autorizim për vënien në treg.

Autorizimin sipas paragrafit 1 të këtij neni e jep Ministria me kërkesë të furnizuesit.

Autorizimi për vënien në treg të lëndëve plasëse jepet në qoftë se ka përputhshmërinë e saj me kërkesat teknike të vlerësuara në procedurën e parashikuar dhe të treguar në përputhje me këtë ligj.

Me kërkesën për dhënie autorizimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, bashkëlidhen:

- Deklarimi për bashkërendimin me kërkesat teknike;
- Udhëzimet për përdorimin, ruajtjen dhe asgjësimin e lëndëve plasëse;
- Të dhënat për shenjën dhe mënyrën e shënimit të lëndës plasëse;

Udhëzimet nga paragrafi 4 nënparagrafi 2 i këtij neni duhet të jetë i shkruar në mënyrë të kuptueshme, në gjuhën malazeze.

Kërkesat teknike dhe procedurat për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve teknike, si dhe shenjat dhe mënyra e shënimit të lëndëve plasëse, përcaktohen me akt nënligjor të cilin e miraton Ministria në bashkëpunim me organin administrativ shtetëror kompetent për çështjet e zhvillimit ekonomik.

Procedura e vlerësimit të bashkërendimit

Neni 13

Përputhshmëria e lëndës plasëse me kërkesat teknike në procesin e vlerësimit të përputhshmërisë, sigurohet me zbatimin e një prej veprimeve të mëposhtme:

- 1) Me testimin fillestar të llojit të produktit (procedura B) nga ana e personit juridik ose fizik i

autorizuar për vlerësimin e bashkërendimit dhe, sipas zgjedhjes së prodhuesit, me verifikimin e përputhshmërisë me llojin e produktit (verifikimi i llojit):

- Me testimin e kampioneve të rastësishme të produkteve (procedura C) nga ana e personit juridik ose fizik, i autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë me llojin e certifikuar të produktit (përputhshmëria me llojin);

- Me sigurimin e cilësisë së prodhimit nëpërmjet vlerësimit të sistemit të cilësisë, nëpërmjet kontrollit nga ana e personit juridik ose fizik të autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë (procedura D);

- Me sigurimin e cilësisë së produktit nëpërmjet vlerësimit të sistemit të cilësisë, me mbikëqyrje nga ana e personit juridik ose fizik të autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë (procedura E);

- Me kontrollin dhe testimin e çdo produkti (verifikimi i produktit) nga ana e personit juridik ose fizik i autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë (procedura F);

2) Me kontrollin dhe testimin e përputhshmërisë së çdo produkti me kërkesat teknike (verifikimi një nga një) nga ana e personit juridik ose personit fizik të autorizuar për vlerësimin e përputhshmërisë (procedura G)

Caktimi, respektivisht autorizimi për kryerjen e veprimeve për vlerësimin e përputhshmërisë

Neni 14

Veprimet sipas nenit 13 i këtij ligji mund t'i kryejë personi juridik ose fizik i cili emërohet me vendim, pra e ngarkon Ministria, në përputhje me aktet nënligjore me të cilat rregullohen kërkesat teknike për prodhimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së produktit me kërkesat e parashikuara.

Dokumentet dhe shenjat e përputhshmërisë

Neni 15

Dokumentet dhe shenjat e përputhshmërisë së lëndëve plasëse të cilat janë dhënë në shtet tjetër, vlejné në Malin e Zi në qoftë se Ministria vlerëson se janë zbatuar procedurat e përputhshmërisë në shkallën e duhur, në harmoni me aktet nënligjore teknike ekuivalente që zbatohen në Malin e Zi, në përputhje me ligjin.

Kushtet dhe mënyra e pranimit të dokumenteve dhe shenjave të përputhshmërisë të cilat janë dhënë në shtetin e huaj i parashikon Ministria, në bashkëpunim me organin administrativ shtetëror me kompetenca për çështjet e zhvillimit ekonomik.

+

[Korrigjimin - 58/2008-8.](#)

Shih:

Marrja e kampioneve

Neni 16

Ministria mund të marrë kampionet e lëndëve plasëse të cilat janë në treg për verifikimin e përputhshmërisë.

Në qoftë se ka dyshim se përdorimi i mëtejshëm i lëndëve plasëse mund të kërcënojë jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisin jetësor dhe pronën, Ministria, deri në vlerësimin e përputhshmërisë, do të ndalojë përkohësisht tregtinë dhe përdorimin e lëndëve plasëse.

Në qoftë se kampioni i marrë nuk i përgjigjet kërkesave teknike të parashikuara, Ministria do të ndalojë tregtinë dhe përdorimin e lëndëve plasëse, ndërsa furnizuesi është i detyruar t'i asgjësojë ato ose t'ia kthejë prodhuesit.

Verifikimin e përputhshmërisë e kryen personi juridik ose fizik sipas nenit 14 të këtij ligji, ndërsa shpenzimet e verifikimit të përputhshmërisë i përballon furnizuesi, në qoftë se konstatohet se kampioni nuk u përgjigjet kërkesave të parashikuara teknike.

Lista e lëndëve plasëse

Neni 17

Ministria, në bazë të lejeve të dhëna sipas nenit 12 paragrafi 2 të këtij ligji, përcakton listën e lëndëve plasëse të cilat mund të vendosen në treg.

Lista sipas paragrafit 1 të këtij ligji publikohet në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi”.

Ambalazhi dhe paketimi

Neni 18

Lëndët plasëse mund të vihen në treg, transportohen dhe përdoren vetëm në paketim origjinal, i cili është testuar dhe është shënuar me tregues në përputhje me rregulloret për transportin e lëndëve plasëse.

Krahas shenjave sipas paragrafit 1 të këtij ligji, mbi ambalazh duhet të gjenden edhe këto të dhëna:

- data e prodhimit dhe afati i përdorimit të lëndës plasëse;
- udhëzimi për përdorim;
- paralajmërime të veçanta, në qoftë se ka;
- treguesi i kategorisë për pajisjen piroteknike.

2. Administrimi

Kushtet për administrimin e lëndëve plasëse

Neni 19

Lëndën plasëse mund ta administrojë personi fizik:

- i cili është më i madh se 21 vjeç dhe më i ri se 65 vjeç;
- i cili me vendim të formës së prerë nuk është dënuar për vepra penale për të cilat hetohet sipas detyrimit zyrtar, përveç se për vepra penale kundër sigurisë së transportit publik;
- kundër të cilit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë për vepra penale kundër: jetës dhe trupit, rendit kushtetues dhe sigurisë së Malit të Zi, njerëzimit dhe vlerave të tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, sigurisë së përgjithshme, pronës dhe rendit publik;
- i cili gjatë tre viteve të fundit nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje kundër rendit dhe qetësisë publike me elemente të dhunës;
- i cili ka aftësi shëndetësore për administrimin e lëndëve plasëse;
- i cili është i kualifikuar profesionalisht për administrimin e lëndëve plasëse ose është aftësuar për kryerjen e punëve të përgatitjes së minimumit, në përputhje me këtë ligj.

Aftësia shëndetësore për administrimin e lëndëve plasëse, tregohet në bazë të vërtetimit për aftësinë shëndetësore, të cilën e jep institucioni shëndetësor në përputhje me rregulloret për armatimin.

Programin dhe mënyrën e kualifikimit profesional për administrimin e lëndëve plasëse nga paragrafi 1 nënparagrafi 6 i këtij neni e përcakton Ministria me akt nënligjor.

Aftësitë profesionale për administrim

Neni 20

Në mënyrë të veçantë, personi i cili nuk është kualifikuar profesionalisht, mund të administrojë lëndët plasëse vetëm nën mbikëqyrjen e personit i cili është kualifikuar profesionalisht për administrim dhe në qoftë se është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, rreziqet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.

Personi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është i detyruar që me deklaratë me shkrim të pohojë që është njohur me mënyrën e punës, rreziqet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.

3. Prodhimi

Përkufizime

Neni 21

Prodhimi i lëndëve plasëse, në përmbajtje të këtij ligji, është procesi i cili përfshin vendosjen e lëndës së parë me karakter plasës, përpunimin, përgatitjen, transportin e brendshëm dhe ruajtjen e produkteve të gatshme me karakter plasës tek prodhuesi.

Leja për prodhim

Neni 22

Prodhuesi i cili mund të jetë shoqëri tregtare, person tjetër juridik dhe sipërmarrës, i cili është regjistruar për prodhim të lëndëve plasëse dhe që ka leje për prodhimin e lëndëve plasëse.

Lejen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni e jep Ministria.

Leja për prodhim mund të përmbajë masa shtesë për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen e pronës.

Kushtet për prodhim

Neni 23

Prodhuesi duhet të ketë:

- person përgjegjës;
- person i cili do të administrojë lëndët plasëse gjatë prodhimit;
- Objekt për prodhim dhe ruajtje.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 nënparagrafi 1 të këtij neni duhet të ketë nivel të lartë profesional të drejtimit përkatës dhe të plotësojë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij ligji.

Kërkesa për dhënie leje

Neni 24

Prodhuesi, me kërkesën për dhënie leje për prodhim të lëndëve plasëse duhet të bashkëlidhë:

- aktin për regjistrimin në regjistrin Qendror të Gjykatës Tregtare;
- të dhënat për personin përgjegjës;
- të dhënat për personat të cilët do të administrojnë lëndët plasëse gjatë prodhimit;
- lejen përkatëse për objektin për prodhim dhe ruajtje;
- provat për plotësimin e kushteve sipas neneve 6, 7 dhe 8 të këtij ligji;
- të dhënat për emërtimin dhe llojin e lëndëve plasëse që do të prodhojë;
- studimin për procedurat teknologjike të përpunimit;
- përshkrimin e sistemit të kontrollit të cilësisë.

Riciklimi (demontimi) dhe neutralizimi

Neni 25

Prodhuesi mund të kryejë riciklim (demontim) dhe neutralizim të lëndëve plasëse.

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes për prodhim.

Neni 26

Leja për prodhimin e lëndëve plasëse ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të prodhuesit ose në qoftë se prodhuesi nuk i plotëson më kushtet sipas nenit 23 të këtij ligji.

Prodhuesi është i detyruar që t'i dërgojë Ministrisë evidencat që ka administruar në bazë të këtij ligji, në afatin prej tetë ditësh nga dita e përfundimit të vendimit për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për prodhimin e lëndëve plasëse.

Vendosja në objektet për ruajtje

Neni 27

Prodhuesi është i detyruar që lëndët plasëse t'i vendosë në objekte për ruajtje të cilat janë pjesë përbërëse e objektit.

Kërkimi i llojeve të reja të lëndëve plasëse

Neni 28

Me kërkime të llojeve të reja të lëndëve plasëse mund të merren prodhuesit si dhe persona të tjerë juridikë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara me aktet nënligjore mbi veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe kualifikimit të lartë dhe në qoftë se kanë kushtet teknike të sigurisë dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e jetës, shëndetit të njerëzve, kafshëve e bimëve, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e pronës.

Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të kryejnë kërkime të llojeve të reja të lëndëve plasëse në bazë të lejes për kërkim.

Lejen për kërkim sipas paragrafit 2 të këtij neni e jep Ministria.

Dokumenti për bashkërendimin, specifikimet teknike dhe udhëzim

Neni 29

Prodhuesi është i detyruar që për çdo lloj lënde plasëse të ketë:

- dokument për bashkërendimin me kërkesat teknike;
- specifikimet teknike;
- udhëzime për përdorimin, ruajtjen dhe asgjësimin e lëndëve plasëse.

Prodhuesi i lëndëve plasëse është i detyruar që me dokumentacionin sipas paragrafit 1 të këtij neni, të ketë edhe treguesin e kategorisë së pajisjeve piroteknike.

Njoftimi mbi fillimin, ndryshimet dhe ndërprerjen e kryerjes së aktivitetit

Neni 30

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik dhe sipërmarrësi të cilit i është miratuar prodhimi, transporti dhe përdorimi i lëndëve plasëse, është i detyruar që, në afatin prej tetë ditësh nga dita e fillimit, ndryshimeve ose ndërprerjes së aktivitetit, të njoftojë Ministrinë.

+

[Korrigjimin - 58/2008-8.](#)

Shih:

4. Transporti

Përkufizime

Neni 31

Me tregti të lëndëve plasëse në përmbajtje të këtij neni, nënkuptohet shitja e lëndëve plasëse për shoqërinë tregtare, personin tjetër juridik, sipërmarrësin dhe personin fizik, të cilët kanë leje për prokurim të lëndëve plasëse si dhe ruajtje në lidhje me shitjen.

Tregti me lëndë plasëse në përmbajtje të këtij ligji nuk konsiderohet shitja me pakicë e pajisjeve piroteknike për zbavitje të kategorisë I dhe II, municionet, baruti, siguresit me djegie të ngadaltë dhe kapsollat iniciuese për municionin në objektet shitëse të shoqërive tregtare, personave të tjerë juridikë dhe sipërmarrës, të cilëve u është dhënë leje për tregti, në bazë të akteve nënligjore përkatëse.

Leja për tregtim

Neni 32

Tregtimin e lëndëve plasëse e kryen shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës i cili është i regjistruar për kryerje të këtij aktiviteti dhe ka lejen për tregti të lëndëve plasëse.

Lejen e lëndëve plasëse sipas këtij neni e jep Ministria.

Leja për tregti të lëndëve plasëse mund të përmbajë masat shtesë për mbrojtjen e jetës së njeriut, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, të jetës dhe bimëve, të mjedisit jetësor dhe pronës.

Kushtet për kryerjen e tregtisë

Neni 33

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës sipas nenit 32 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të ketë:

- person përgjegjës;
- objekt për ruajtje, respektivisht magazinë për të cilën është dhënë leja përkatëse.

Personi përgjegjës sipas paragrafit 1 nënparagrafi 1 i këtij neni duhet të ketë nivel të lartë kualifikimi në drejtimin përkatës dhe të plotësojë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij ligji.

Kërkesa për dhënie leje për tregti

Neni 34

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik dhe sipërmarrësi, me kërkesën për dhënie leje për tregti me lëndë plasëse, bashkëlidh:

- aktin për regjistrimin në regjistrin Qendror të Gjykatës Tregtare;
- të dhënat për personin përgjegjës
- provat mbi plotësimin e kushteve nga nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji;
- provë që ka objekt për ruajtje, respektivisht magazinë sipas nenit 33 paragrafi 1 nënparagrafi 2 i këtij neni.

Detyrimet e shitjes në sasi të paraqitura në lejen për blerje

Neni 35

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik dhe sipërmarrësi, të cilët kryejnë tregti, mund t'i shesin lëndë plasëse vetëm shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik, sipërmarrësit ose personit fizik, të cilët kanë leje për prokurim të lëndëve plasëse në sasi të paraqitura në lejen për prokurimin e lëndëve plasëse.

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes për tregti

Neni 36

Leja për tregti të lëndëve plasëse ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të zotëruesit të lejes për tregti me lëndë plasëse ose në qoftë se poseduesi i kësaj leje nuk i plotëson më kushtet e përmendura në nenin 33 të këtij ligji.

Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të detyruar që t'i dërgojnë Ministrisë evidencat që kanë mbajtur në bazë të këtij ligji, në afatin prej tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e lejes për tregti të lëndëve plasëse.

5. Prokurimi

Leja për prokurim

Neni 37

Lejen për prokurimin e lëndëve plasëse e jep Ministria me kërkesë të shoqërisë tregtare, të një personi tjetër juridik, sipërmarrësit ose personit fizik, të cilët kanë leje për përdorimin e lëndëve plasëse.

Leja për prokurimin e lëndëve plasëse jepet për një periudhë prej tre muajsh. Kërkesa për dhënie leje sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban të dhëna për:

- aplikuesin e kërkesës (emrin dhe selinë, respektivisht emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin e letërnjoftimit)
- emërtimin, sasinë, mënyrën e paketimit, prodhuesin e lëndës plasëse, me shkaqet dhe justifikimin për blerjen;
- vendin dhe kohën e detajuar të përdorimit;

- personin i cili do të marrë në ngarkim lëndën plasëse;
- personin i cili do të administrojë lëndët plasëse;
- mënyrën dhe kushtet e ruajtjes.

Aplikuesit për dhënie leje për prokurim të lëndëve plasëse, Ministria mund t'i caktojë masa sigurie shtesë ose masa të tjera të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës.

Leja ndaj personit fizik për prokurim

Neni 38

Personit fizik mund t'i miratohet prokurimi i jo më shumë se pesë kilogramë lëndë plasëse, 50 copë pjesë për ndezje dhe sasia përkatëse e siguresit me djegie të ngadaltë.

Lëndët plasëse sipas paragrafit 1 të këtij neni mund t'i administrojë vetëm personi të cilit i është dhënë miratim për kryerjen e punimeve të minimimit, në përputhje me këtë ligj.

Në lejen për prokurim të lëndëve plasëse që i jepet personit fizik, përcaktohet edhe vendi i prokurimit të kësaj lënde, që është në vendin më të afërt të përdorimit të lëndëve plasëse.

Personi fizik i cili ka prokuruar lëndë plasëse, është i detyruar që pas përdorimit, pjesën e tepërt të këtyre lëndëve t'ia kthejë shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik ose sipërmarrësit, nga i cili ka blerë lëndën plasëse ose të sigurojë që t'i asgjësojë ato personi me përgatitje profesionale dhe për këtë të njoftojë Ministrinë dhe organin administrativ kompetent për çështjet e policisë.

Personi fizik i cili prokuron pajisje piroteknike të kategorisë I dhe II për nevojat e veta, nuk mund të ketë leje për blerje.

Leja për prokurim të shumëfishtë

Neni 39

Shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik dhe sipërmarrësit, veprimtaria e të cilit kërkon përdorim të rregullt të lëndëve plasëse, në varësi nga mundësitë e ruajtjes dhe volumit të harxhimit të lëndëve plasëse, mund t'i jepet leje për prokurim të shumëfishtë të këtyre lëndëve.

Leja nga paragrafi 1 i këtij neni jepet për një periudhë prej tre muajsh.

Prokurimi i lëndëve plasëse në sasi të që mund të ruhen

Neni 40

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrës, mund të prokurojë lëndë plasëse të nevojshme për kryerjen e veprimeve të minimimit dhe të pajisjeve piroteknike për shfaqje publike me fishekzjarre në sasi të që mund të ruhen.

Numri i kopjeve të lëshuara për leje për prokurim

Neni 41

Leja për prokurim të lëndëve plasëse, i jepet aplikuesit të kërkesës në dy kopje.

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik dhe sipërmarrësi, të cilët merren me tregti të lëndëve plasëse, janë të detyruar që gjatë shitjes së lëndëve plasëse, në të dyja kopjet e lejes për prokurim të lëndëve plasëse, të paraqesë llojin dhe sasinë e lëndës plasëse të shitur, që njërin kopje ta mbajnë për vete dhe kopjen tjetër t'ia dorëzojnë personit që kryen prokurimin.

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi, të cilët përdorin lëndë plasëse, mund të prokurojnë lëndë plasëse tek shumë furnizues, me kushtin që secili furnizues në anën e pasme të lejes të tregojë sasinë dhe llojin e lëndës plasëse të dhënë dhe ta vërtetojë atë me nënshkrimin dhe vulën e personit përgjegjës.

+

Korrigjimin - 58/2008-8.

Shih:

Kontejneri për ruajtje

Neni 42

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi, të cilët kryejnë punimet e minimimit, janë të detyruar që në kantiere të kenë kontejnerë për ruajtjen e lëndëve plasëse të papërdorura.

6. Përdorimi

Vendi i përdorimit

Neni 43

Lëndët plasëse mund të përdoren në vende të cilat janë parashikuar në lejen për prokurim ose përdorim të këtyre lëndëve.

Ndalimi i përdorimit

Neni 44

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi, mund të përdorë lëndët plasëse për kryerjen e punimeve në kantiere ndërtimi ose vende të tjera të ngjashme vetëm në qoftë se janë marrë masat për objektin e tij të ruajtjes ose kontejnerin.

Lëndët plasëse nuk mund të përdoren në vende ku organi kompetent ka urdhëruar ndalimin e kryerjes së veprimeve, kryerja e të cilave kërkon përdorimin e këtyre lëndëve.

1) Përdorimi i pajisjeve piroteknike

Llojet e pajisjeve piroteknike

Neni 45

Pajisjet piroteknike, në varësi të sasisë dhe llojit të përzierjes piroteknike, respektivisht të mbushjes piroteknike, nivelit të zhurmës dhe kushteve të tjera të sigurisë, ndahen në:

- Pajisje piroteknike të kategorisë I – lojëra piroteknike
- Pajisje piroteknike të kategorisë II – pajisje për fishekzjarre të vegjël;
- Pajisje piroteknike të kategorisë III – pajisje për fishekzjarre mesatarë;
- Pajisje piroteknike të kategorisë IV – pajisje për fishekzjarre të mëdhenj.

Lloji, karakteristikat, etiketimi, kushtet teknike, kushtet e ruajtjes dhe të përdorimit të pajisjeve teknike, rregullohen në mënyrë të detajuar nëpërmjet aktit nënligjor të Ministrisë.

Lejet

Neni 46

Fishekzjarrë në ambient publik mund të shfaqë shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës i cili ka leje për kryerje aktiviteti me shfaqje fishekzjarresh në ambient publik dhe leje për shfaqje fishekzjarresh në ambient publik.

Lejen nga paragrafi 1 i këtij neni e jep Ministria.

Kushtet për kryerjen e aktivitetit me fishekzjarre në ambient publik

Neni 47

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrësi sipas nenit 46 paragrafi 1 të këtij ligji, duhet të ketë:

- person përgjegjës;
- objekt për ruajtje, respektivisht magazinë për të cilën është dhënë leja përkatëse;
- Të paktën person të punësuar i cili është i kualifikuar profesionalisht për shfaqje me fishekzjarre në ambient publik.

Personi përgjegjës nga paragrafi 1 nënparagrafi 1 i këtij neni, duhet të ketë kualifikim profesional të lartë ose koleg të drejtimit përkatës dhe të plotësojë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij

ligji.

Programi dhe mënyra e kualifikimit profesional dhe e dhënies së provimit profesional për personin i cili shfaq fishekzjarre në ambient publik, përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

Kërkesa për dhënie leje për kryerje të aktivitetit me fishekzjarre publikë

Neni 48

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi, me kërkesën për dhënie leje për kryerje aktiviteti me fishekzjarre në ambient publik, bashkëlidh:

- aktin për regjistrimin në regjistrin Qendror të Gjykatës Tregtare;
- të dhënat për personin përgjegjës;
- të dhënat për personin e punësuar që është kualifikuar profesionalisht për shfaqje fishekzjarresh në ambient publik;
- provat që ka objekt për ruajtje, respektivisht magazinë, për të cilën është dhënë leje përdorimi.

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes për zhvillim shfaqje fishekzjarresh në ambient publik

Neni 49

Leja për kryerje aktiviteti me fishekzjarre në ambient publik ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të zotëruesit të lejes për kryerje aktiviteti publik me fishekzjarre ose në qoftë se zotëruesi i kësaj leje nuk plotëson më kushtet nga neni 47 i këtij ligji.

Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të detyruara që t'i dërgojnë Ministrisë evidencat që kanë administruar në bazë të këtij ligji, në afatin prej tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për kryerjen e aktivitetit me fishekzjarre publike.

Llojet e fishekzjarrëve

Neni 50

Fishekzjarret publike janë fishekzjarre profesionale dhe fishekzjarre për efekte skenike.

Fishekzjarret profesionale shfaqen me pajisje të miratuara piroteknike të kategorisë II, III dhe IV, në sipërfaqet të cilat janë përgatitur posaçërisht për këtë qëllim dhe në distancën e parashikuar të objekteve, komunikimeve dhe objekteve të tjera.

Fishekzjarret për efekte skenike shfaqen në institucionet teatrale dhe të ngjashme, në studiot e filmit dhe ato televizive ose në ambiente të hapura, me pajisje të miratuara piroteknike të kategorisë I, II, III dhe IV, si dhe me lëndë të tjera plasëse që përdoren për këto qëllime.

Leja për shfaqje fishekzjarresh publik

Neni 51

Leja për shfaqje me fishekzjarre publike jepet me kërkesë të shoqërisë tregtare, të personit tjetër juridik dhe sipërmarrësit, i cili ka leje për kryerje aktiviteti të fishekzjarreve publike.

Nëpërmjet lejes për shfaqje fishekzjarresh publike parashikohet lloji dhe kategoria e pajisjeve piroteknike për këtë qëllim, si dhe vendi dhe koha e shfaqjes me fishekzjarre në ambient publik.

2) *Minimi*

Llojet e minimimit

Neni 52

Aktivitetet e minimimit janë: minimi nëntokësor, minimi special, minimi nëntokësor dhe minimi gjatë çminimit.

Minime nëntokësore janë: minimi në sipërfaqe, minimi në ndërtim, minimi gjatë shpyllëzimit (nxjerrja e trungjeve) dhe gërmimi i gropave për fidanë dhe minimi për copëtimin e copave të mëdha të shkëmbinjve.

Minimet speciale janë: minimi nëntokësor, minimi i objekteve të ndërtimit, minimi në kërkimet sizmike, minimi teknologjik dhe minimi gjatë punimit të tuneleve dhe ambienteve të tjera nëntokësore, përveç minimeve nëntokësore gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para minerale.

Minimet nëntokësore përfshijnë veprimet e minimimit nëntokësor gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para minerale.

Minime gjatë çminimit janë minimet të cilat kryhen gjatë kryerjes së veprimeve të çminimit.

Leja për kryerjen e veprimtarisë së çminimit.

Neni 53

Veprimet e minimimit mund t'i kryejë një shoqëri tregtare, person juridik ose sipërmarrës i cili ka leje për kryerjen e veprimtarisë së minimimit.

Lejen nga paragrafi 1 të këtij neni e jep Ministria.

Kushtet për kryerjen e veprimeve të minimimit.

Neni 54

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik dhe sipërmarrësi sipas nenit 53 paragrafi 1 të këtij neni duhet të ketë:

- person përgjegjës;
- të paktën një person të punësuar të cilit i është dhënë miratim për kryerjen e minimimit në përputhje me këtë ligj;
- objekt për ruajtje, respektivisht magazinë për të cilën është dhënë leja e përdorimit.

Personi përgjegjës nga paragrafi 1 nënparagrafi 1 i këtij neni duhet të ketë kualifikim profesional të lartë ose kolegji të drejtimit përkatës dhe të plotësojë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij ligji.

Kërkesa për dhënie leje

Neni 55

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik dhe sipërmarrësi, me kërkesën për dhënie leje për kryerje të veprimeve të minimimit, bashkëlidh:

- aktin për regjistrimin në regjistrin Qendror të Gjykatës Tregtare;
- të dhënat për personin përgjegjës;
- të dhënat për personin e punësuar të cilit i është dhënë leje për kryerjen e punëve të minimimit në bazë të këtij ligji;
- provë që ka objekt për ruajtje, respektivisht magazinë për të cilën është dhënë leja e përdorimit.

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes

Neni 56

Leja për kryerjen e veprimtarisë së minimimit ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të zotëruesit të lejes për kryerje veprimtarie minimi ose në qoftë se zotëruesi i kësaj leje nuk i plotëson më kushtet nga neni 54 i këtij ligji.

Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të detyruar që t'i dërgojnë Ministrisë evidencat që kanë mbajtur në bazë të këtij ligji, në afatin prej tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë për kryerje të veprimtarisë së minimimit.

Plani i minimimit dhe masat e sigurisë

Neni 57

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të minimimit, shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrësi, është i detyruar që të marrë masa sigurie dhe të kryejë minimin sipas planit të minimimit, në mënyrë që minimi të mos kërcënojë jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisin jetësor dhe pronën.

Plani i minimimit nga paragrafi 1 i këtij neni përpunohet nga personi që ka kualifikim të lartë profesional të shkencës minerare dhe ka dhënë provimin e specialitetit, në bazë të rregulloreve për minierat.

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrësi që kryen detyrat e minimimit, është i detyruar që për minimet që kryhen në vend të banuar ose në afërsi të vendbanimit, jo më vonë se 24 orë para kryerjes së minimimit, të njoftojë Ministrinë, organin administrativ kompetent për çështjet e policisë dhe publikun, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, dhe tre ditë para kryerjes së minimimit në afërsi të rrugëve, hekurudhave, ujësjellësve, linjave elektrike ose telefonike dhe objekteve të ngjashme, të njoftojë me shkrim shoqëritë tregtare dhe persona të tjerë juridik të cilët i administrojnë këto objekte.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit nëntokësor

Neni 58

Minimi nëntokësor mund të kryhet nga person i punësuar sipas nenit 54 paragrafi 1 nënparagrafi 3 i këtij ligji, të cilit i është dhënë leje për kryerje të punimeve të minimimit nëntokësor.

Lejen sipas paragrafit 1 të këtij neni e jep Ministria.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit nëntokësor mund t'i jepet personit sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili ka:

- kualifikim profesional të mesëm, të lartë ose kolegji të profesionit përkatës;
- marrë provimin profesional për kryerjen e punimeve të minimimit;
- katër vjet eksperiencë pune në veprimtarinë e përgatitjes së minimimit, në qoftë se ka kualifikimin profesional të mesëm ose dy vjet eksperiencë pune në këto veprimtari, në qoftë se ka kualifikim profesional të lartë ose kolegji.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit special

Neni 59

Minimi special mund të kryhet nga një person i punësuar sipas nenit 54 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të këtij ligji, të cilit i është dhënë leje për kryerjen e punimeve të minimimit special.

Lejen nga paragrafi 1 të këtij neni e jep Ministria.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit special mund t'i jepet personit nga paragrafi 1 të këtij neni, i cili plotëson kushtet nga neni 19 paragrafi 1 i këtij ligji dhe ka:

- kualifikim profesional të lartë ose kolegji të profesionit përkatës;
- ka marrë provimin profesional për kryerjen e punimeve të minimimit;
- pesë vjet eksperiencë pune në veprimtarinë e minimimit në qoftë se ka kualifikim profesional të lartë, ose katër vjet eksperiencë pune në këto veprimtari në qoftë se ka kualifikim profesional kolegji.

Leja për kryerjen e minimimit nëntokësor

Neni 60

Minimi nëntokësor mund të kryhet nga person i punësuar sipas nenit 54 paragrafi 1 nënparagrafi 3 i këtij ligji, të cilit i është dhënë leje për kryerjen e punimeve të minimimit nëntokësor.

Leja sipas paragrafit 1 të këtij neni jepet nga Ministria.

Leja për kryerje të punimeve të minimimit nëntokësor mund t'i jepet personit sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili plotëson kushtet nga neni 58 paragrafi 3 i këtij ligji.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit gjatë çminimit

Neni 61

Minimi gjatë procesit të çminimit mund të kryhet nga person i punësuar sipas nenit 54 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të këtij ligji, të cilit i është dhënë leje për kryerjen e punimeve të minimimit gjatë procesit të çminimit.

Lejen sipas paragrafit 1 të këtij neni e jep Ministria.

Leja për kryerjen e punimeve të minimimit gjatë çminimit mund t'i jepet personit sipas paragrafit 1

të këtij neni, i cili ka:

- kualifikim profesional të mesëm, të lartë ose kolegji në profesionin përkatës;
- dhënë provimin profesional për kryerjen e punimeve të minimimit;
- Dy vjet eksperiencë pune në veprimtaritë e çminimit ose të minimimit, në qoftë se ka kualifikim profesional të mesëm ose një vit eksperiencë pune në këto veprimtari, në qoftë se ka kualifikim profesional të lartë ose kolegji.

Provimi profesional

Neni 62

Mënyra e kualifikimit, programi dhe mënyra e dhënies së provimit profesional për kryerje të punimeve të minimimit sipas neneve 58, 59, 60 dhe 61 të këtij ligji rregullohen me akt nënligjor të Ministrisë.

Aktivitetet e përgatitjes së minimimit

Neni 63

Aktivitetet e përgatitjes së minimimit (mbushja e gropave me lëndë plasëse, vendosja e pajisjeve për aktivizim etj.) mund të kryhen nga personi fizik (më tej në tekst referuar si: Minatori) i cili:

- plotëson kushtet sipas nenit 19 paragrafi 1 të këtij ligji;
- ka të paktën kualifikim profesional të mesëm;
- është kualifikuar për kryerjen e punimeve të minimimit, për të cilat disponon vërtetim të dhënë në përputhje me rregullat për minierat.

Aktivitetet ndihmëse në përgatitje të minimimit (transportimi i lëndëve plasëse, ngarkimi, shkarkimi etj.), nën mbikëqyrjen e minatorit, mund t'i kryejë personi fizik me shkollë fillore i cili është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, rreziqet dhe rregullat gjatë administrimit të lëndëve plasëse.

7. Asgjësimi i lëndëve plasëse

Kushtet dhe mënyra e asgjësimit të lëndëve plasëse

Neni 64

Lëndët plasëse asgjësohen në bazë të udhëzimit të prodhuesit në vendet ku është i lejuar përdorimi i lëndëve plasëse, ndërsa asgjësimi kryhet në mënyrë që të mos rrezikojë jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisin jetësor dhe pronën.

Lëndët plasëse mund t'i asgjësojë vetëm personi specialist sipas nenit 19 pika 1 e këtij ligji.

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrësi dhe personi fizik, është i detyruar që për mënyrën, sasinë, vendin dhe kohën e asgjësimit të lëndëve plasëse të panevojshme dhe ambalazheve të panevojshme, të njoftojë Ministrinë dhe organin administrativ shtetëror kompetent për çështjet e policisë 24 orë para ditës së caktuar për asgjësim.

Në qoftë se gjatë asgjësimit të lëndëve plasëse parashikohet shpërthim i fuqishëm, shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi, është i detyruar të veprojë në bazë të nenit 57 paragrafi 3 të këtij ligji.

IV. OBJEKTET PËR PRODHIM DHE RUAJTJE

Masat e sigurisë gjatë ndërtimit dhe përgatitjes

Neni 65

Objektet për prodhim dhe ruajtje të lëndëve plasëse duhet të jenë ndërtuar dhe përgatitur në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e jetës, e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës.

Vendi për ndërtim

Neni 66

Mendimin për vendin e ndërtimit të objekteve për prodhim dhe ruajtje, të magazinës dhe të vendosjes së kontejnerëve, e jep Ministria.

Miratimin ndaj dokumentacionit projektues dhe tekniko-investues për ndërtimin e objekteve për

prodhim dhe ruajtje dhe të magazinave, nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri, e jep Ministria.

Vendosja e kontejnerit

Neni 67

Kontejnerët për vendosjen e lëndëve plasëse mund të vendosen vetëm në vende të cilat i cakton Ministria në bazë të ligjit me të cilin parashikohen masat për mbrojtjen nga zjarri.

Në kontejner mund të vendosen aq lëndë plasëse sa është parashikuar me rregulloren teknike, respektivisht sa është paraqitur në certifikatën që ka dhënë prodhuesi i kontejnerit.

Ruajtja e disa llojeve të lëndëve plasëse

Neni 68

Në objektet për prodhim dhe ruajtje, magazina dhe kontejnerë në të cilët ruhen shumë lloje lëndësh plasëse, këto lëndë duhet të vendosen në ambiente të ndara ose në strehë të ndërtuara posaçërisht për këtë.

Mjetet ndezëse nuk duhet të mbahen në objekte për prodhim dhe ruajtje, magazina dhe kontejnerë, bashkërisht me lëndët plasëse, vetëm në qoftë se në këto objekte ka ambiente të përgatitura posaçërisht për këtë.

Ndriçimi

Neni 69

Brendësia e objekteve për prodhim dhe ruajtje, magazinave dhe kontejnerëve, sipas rregullit, duhet të jetë e ndriçuar me dritë ditore.

Në qoftë se objektet për prodhim dhe ruajtje, magazinat dhe kontejnerët ndriçohen me ndriçim elektrik, instalimet elektrike duhet të jenë kryer në përputhje me rregulloren teknike dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt.

Ngrohja

Neni 70

Objektet për prodhim dhe ruajtje, magazinat dhe kontejnerët, si rregull, nuk ngrohen, por në qoftë se ngrohja e ambienteve të caktuara është e domosdoshme, ajo duhet të kryhet në përputhje me rregullat teknike.

Ventilimi

Neni 71

Objektet për prodhim dhe ruajtje, magazinat dhe kontejnerët duhet të kenë ventilim.

Vrimat për ventilim duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë që të mos mbyllen e bllokohen, dhe nëpërmjet tyre nuk duhet të depërtojë ujë në objektet për prodhim dhe ruajtje, në magazina dhe kontejnerë.

Aparatet, pajisjet dhe instalimet rrufepritëse

Neni 72

Objektet për prodhim dhe ruajtje, magazinat dhe kontejnerët duhet të jenë të pajisura me aparate dhe pajisje të tjera për fikje zjarri dhe të kenë instalim kundër rufesë.

Ambalazhi dhe paketimi

Neni 73

Lëndët plasëse mbahen në objekte për prodhim dhe ruajtje, në magazina dhe kontejnerë në paketimin e përshkruar dhe të renditur në mënyrë e parashikuar në rregullat teknike.

Përdorimi

Neni 74

Përdorimin e objekteve për prodhim dhe ruajtje e miraton Ministria me vendim të saj, vetëm pasi komisioni i organit kompetent të ketë kryer kontrollin teknik të këtyre objekteve.

Me vendim nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen edhe llojet dhe sasi të lëndëve plasëse që

mund të vendosen në objektet për ruajtje.

Miratimi i akteve nënligjore

Neni 75

Përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacionit për dhënie mendimi dhe miratimi sipas nenit 66 të këtij ligji, hapësirat e sigurisë për të gjitha llojet e objekteve për prodhim dhe ruajtje, kushtet të cilat duhet të plotësojnë objektet për prodhim dhe ruajtje dhe vendi, si dhe mënyra e sigurimit të tyre fizik dhe teknik, përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

V. EVIDENCAT

Administrimi i evidencave

Neni 76

Ministria administron evidencat për:

- personat juridikë dhe fizikë të autorizuar dhe të emëruar për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse;
- lëndët plasëse për të cilat është dhënë certifikatë për vendosjen në treg;
- certifikatat e dhëna për prodhimin, tregtinë, prokurimin e lëndëve plasëse, kryerjen e aktivitetit me fishekzjarre publike, shfaqje fishekzjarresh publike, kryerje aktiviteti minimi dhe miratim për kryerje të veprimeve të minimi;
- vendimet e dhëna për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për prodhimin, tregtinë e lëndëve plasëse, kryerjen e aktivitetit me fishekzjarre publike dhe kryerje veprimtarie minimi;
- kampionet e marra të lëndëve plasëse.

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik dhe sipërmarrësi që prodhon lëndë plasëse, mban evidencë për llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura, të asgjësuara, të rikthyera, të humbura ose të vjedhura.

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik dhe sipërmarrësi që kryen tregti, prokurim dhe/ose përdor lëndë plasëse, mban evidencë për llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura, të asgjësuara, të rikthyera, të humbura ose të vjedhura.

Evidencat nga paragrafët. 1 dhe 2 të këtij neni ruhen për 10 vjet, kurse evidencat sipas paragrafit 3 të këtij neni pesë vjet.

Përmbajtja dhe mënyra e administrimit të evidencës nga paragrafët. 1, 2 dhe 3 të këtij neni, i përcakton Ministria.

Neni 77

Për grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave nga evidencat e parashikuara me këtë ligj, zbatohen aktet nënligjore me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave të publikuara dhe personale.

VI. MBIKËQYRJA

Mbikëqyrja inspektuese

Neni 78

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuar në bazë të këtij ligji e kryen Ministria.

Veprimet e mbikëqyrjes inspektuese në këndvështrimin e kompetencave të Ministrisë i kryen inspektori për lëndët plasëse, materialet ndezëse dhe lëngjet e gazet, në përputhje me ligjin me të cilin është rregulluar mbikëqyrja inspektuese.

Masat dhe veprimet administrative

Neni 79

Krahas masave administrative dhe veprimeve të parashikuara me ligjin me të cilin rregullohet mbikëqyrja inspektive, inspektori për lëndët plasëse dhe lëngjet dhe gazet, ka kompetenca edhe që:

- të hyjë dhe kontrollojë objektet dhe ambientet ku kryhet prodhimi, ruajtja, përdorimi, asgjësimi ose tregtia e lëndëve plasëse, si dhe ambientet për të cilat ekziston dyshimi që në to ka lëndë plasëse;
- të inspektojë dokumentacionin që lidhet me lëndët plasëse;
- të inspektojë dokumentet për aftësitë profesionale për administrimin e lëndëve plasëse;
- të verifikojë dhe konfirmojë identitetin e personit që ndeshet në vendet e përdorimit, prodhimit dhe ruajtjes të lëndëve plasëse;
- të ndalojë administrimin nga persona të cilët nuk janë të kualifikuar profesionalisht për

administrimin e lëndëve plasëse;

- të ndalojë prodhimin e lëndëve plasëse dhe veprime të caktuara që kanë të bëjnë me tregtinë, ruajtjen, përdorimin, ngarkimin ose shkarkimin e lëndëve plasëse për shkak të parregullsive të kryera gjatë ndërmarrjes së masave të sigurisë të cilat mund të rrezikojnë jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, ambientit jetësor dhe pronës;

- të urdhërojë eliminimin e parregullsive të konstatuara në afatin e caktuar;

- të urdhërojë masa të tjera në prodhimin, tregtinë dhe përdorimin e lëndëve plasëse të cilat përdoren për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës;

+

Korrigjimin - 58/2008-8.

Shih:

VII. DISPOZITA PENALE

Neni 80

Me dënim me gjobë nga njëzetfish deri tridhjetëfish të pagës më të ulët në Malin e Zi do të dënohet për shkelje shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrësi në qoftë se:

1) nuk miraton aktin e përgjithshëm sipas neni 6 paragrafi 2 të këtij ligji;

2) personat të cilët administrojnë ose kryejnë punë të tjera në lidhje me lëndët plasëse nuk njihen me masat e parashikuara në aktet nga neni 6 paragrafi 2 i këtij ligji ose nuk kualifikohen për të vepruar në rast aksidenti teknologjiko-teknik ose rreziku tjetër, në përmbajtje të rregullores për mbrojtje dhe shpëtim (neni 7);

3) nuk siguron ruajtje të përhershme fizike dhe teknike të objekteve në të cilat kryhet prodhimi ose ruajtja e lëndëve plasëse (neni 8);

4) nuk organizon dhe kontrollon zbatimin e masave të parashikuara të ruajtjes (neni 9);

5) për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse, nuk njofton menjëherë ose jo më vonë se afati prej një ore pasi është vënë në dijeni, Ministrinë ose organin administrativ kompetent për çështjet e policisë.(neni 10);

6) vendos në treg dhe përdor lëndë plasëse për të cilat nuk është dhënë leje për vendosje në treg (neni 12 paragrafi 1);

7) kryen veprime nga neni 13 i këtij ligji pa leje (neni 14 paragrafi 1);

8) lejon që lëndën plasëse ta administrojë personi i cili nuk plotëson kushtet për administrimin e lëndëve plasëse (neni 19 paragrafi 1);

9) fillon prodhimin e lëndëve plasëse pa lejen e Ministrisë (neni 22 paragrafi 2) ose vazhdon të merret me prodhimin kur nuk i plotëson më kushtet nga neni 23 i këtij ligji;

10) kërkon lloje të tjera lëndësh plasëse pa leje të Ministrisë (neni 28 paragrafi 3);

11) kryen tregti të lëndëve plasëse pa lejen e Ministrisë (neni 32 paragrafi 1);

12) i shet lëndë plasëse shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik, sipërmarrësit ose personit fizik, i cili nuk ka leje për prokurimin e lëndëve plasëse (neni 35);

13) prokuron lëndë plasëse pa leje të Ministrisë (neni 37 paragrafi 1);

14) shfaq fishekzjarre publike pa lejen e Ministrisë (neni 46 paragrafi 2);

15) kryen veprimet e minimimit pa leje të Ministrisë (neni 53);

16) gjatë minimimit nuk ndërmerr masa sigurie për ruajtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, ambientit jetësor dhe pronës (neni 57 paragrafi 1);

17) nëpërmjet asgjësimit jo të rregullt dhe joprofesional të lëndëve plasëse, rrezikon jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës (neni 64 paragrafët 1 dhe 2);

18) objektet për prodhim dhe ruajtje për lëndët plasëse nuk i ndërton dhe pajis në mënyrë të tillë që të sigurohet ruajtja e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit jetësor dhe pronës (neni 65);

19) objektet për prodhim dhe ruajtje për lëndët plasëse i ndërton pa marrjen e vendimit për vendin dhe miratimin e projektit dhe dokumentacionit tekniko-investues (neni 66);

20) Kontejnerin e vendos në kundërshtim me nenin 67 të këtij neni;

21) objektet për prodhim dhe ruajtje i përdor pa miratimin e Ministrisë (neni 74).

Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni, me dënim me gjobë nga pesëfishi deri në njëzetfishin e pagës më të ulët në Malin e Zi do të dënohet personi përgjegjës në personin juridik.

+

Shih:

Korrigjimin - 58/2008-8.

Neni 81

Me dënim me gjobë nga njëzetfishi deri dyqintfishi i pagës më të ulët në Malin e Zi do të dënohet për shkelje shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi, në qoftë se:

1) lëndët plasëse i administron personi i cili nuk është i kualifikuar profesionalisht ndërsa nuk është nën mbikëqyrjen e personit i cili është i kualifikuar profesionalisht për administrimin e lëndëve plasëse dhe në qoftë se nuk është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, rreziqet dhe masat e mbrojtjes në punë (neni 20 paragrafi 1);

2) në afatin prej tetë ditësh nga vendimi përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së autorizimit për prodhimin e lëndëve plasëse nuk i dërgon Ministrisë evidencat që ka mbajtur sipas ligjit (neni 26 paragrafi 2);

3) në afatin prej tetë ditësh nuk njofton Ministrinë për fillimin, ndryshimet dhe ndërprerjen e kryerjes së aktivitetit (neni 30);

4) në afatin prej tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e autorizimit për tregti të lëndëve plasëse, nuk i dërgon Ministrisë evidencat që ka mbajtur në bazë të këtij ligji (neni 36 paragrafi 2);

5) prokuron lëndë plasëse të nevojshme për kryerje të veprimeve të minimumit dhe pajisje piroteknike për shfaqje me fishekzjarre në ambient publik në sasi të që nuk mund të ruhen (neni 40);

6) shet lëndë plasëse ndërsa nuk mban kopjen e autorizimit ose në të nuk pasqyron llojin dhe sasinë e lëndës plasëse të shitur (neni 41 paragrafi 2);

7) në kantier nuk ka kontejner për ruajtjen e lëndëve plasëse të përdorura (neni 42);

8) përdor lëndë plasëse të prokuruar në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 2 të këtij ligji;

9) në afatin prej tetë ditësh nga vendimi përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së autorizimit për shfaqje me fishekzjarre në ambient publik, nuk i dërgon Ministrisë evidencat e përshkuara (neni 49 paragrafi 2);

10) shfaq fishekzjarre në ambient publik pa leje ose në qoftë se shfaq fishekzjarre publike në vendin, në kohën, për llojin dhe kategorinë e pajisjeve piroteknike, në kundërshtim me lejen për shfaqje fishekzjarresh publike (neni 51);

11) në afatin prej tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për kryerjen e veprimeve të minimumit, nuk i dërgon Ministrisë evidencat e parashikuara (neni 56 paragrafi 2);

12) nuk ndërmerri masat e sigurisë, nuk përpunon planin e minimumit ose nuk e kryen minimumin sipas planit të minimumit (neni 57 paragrafi 1);

13) kryen veprimet e minimumit në vend të banuar ose në afërsi të vendit të banuar, ndërsa nuk ka njoftuar paraprakisht Ministrinë, organin administrativ publik kompetent për çështjet e policisë, publikun dhe shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë që administrojnë rrugët, hekurudhat, ujësjellësit, linjat elektrike ose telefonike ose objekte të ngjashme (neni 57 paragrafi 3);

14) punët e minimumit nëntokësor, të minimumit special, të minimumit nëntokësor ose të minimumit gjatë çminimumit, i kryejnë persona të cilët nuk leje për kryerjen e punëve të minimumit ose për kryerjen llojeve të veçanta të minimumit (nenet 58, 59, 60 dhe 61);

15) veprimet e përgatitjes së minimumit ose të punimeve ndihmuese në përgatitje të minimumit i kryen personi fizik i cili nuk plotëson kushtet nga neni 63 i këtij ligji;

16) Në objektin për prodhim dhe ruajtje në të cilin ruhen shumë lloje lëndësh plasëse nuk i vendos këto lëndë në ambiente të ndara ose në streha të ndërtuara posaçërisht për këtë, ose mjetet për ndezje i mban bashkë me lëndët plasëse (neni 68);

17) Nuk mban dhe nuk ruan evidencat e parashikuara (neni 76 paragrafët 2, 3 e 4).

Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni, me dënim me gjobë nga pesëfishi deri pesëmbëdhjetëfishi i pagës minimale në Malin e Zi, do të dënohet edhe personi përgjegjës në personin juridik.

Neni 82

Me dënimin me gjobë nga dyfishi deri dhjetëfishin e shumës së vlerës më të ulët të punës në Malin e Zi do të dënohet për shkelje personi fizik në qoftë se:

1) me mbarimin e veprimtarisë, sasinë e mbetur të lëndëve plasëse nuk ia rikthen shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik ose sipërmarrësit tek i cili i ka blerë ose në qoftë se ato nuk i asgjëson personi specialist i kualifikuar dhe për këtë nuk njofton Ministrinë dhe organin administrativ

kompetent për çështjet e policisë (neni 38 paragrafi 4);

2) kryen veprimet e minimimit nëntokësor, të minimimit special dhe/ose nëntokësor dhe/ose minim gjatë çminimit, ndërsa nuk ka miratim për kryerjen e këtyre punëve (neni 58 paragrafi 1, neni 59 paragrafi 1, neni 60 paragrafi 1 dhe neni 61 paragrafi 1);

3) kryen veprime të përgatitjes së minimimit, ndërsa nuk plotëson kushtet nga neni 63 paragrafi 1 i këtij ligji.

Për shkelje nga paragrafi 1 të këtij neni, personit fizik mund t'i komunikohet edhe dënim me gjobë në vendin e ngjarjes deri dyfishin e pagës më të ulët në Malin e Zi.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Afati për miratimin e akteve nënligjore

Neni 83

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij do të miratohen në afatin prej dy vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e akteve nënligjore të këtij neni do të zbatohen dispozitat të cilat kanë qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Lista nga neni 17 i këtij ligji përmban edhe lëndët plasëse për vendosjen në treg të së cilës është dhënë miratim sipas akteve nënligjore të cilat kanë qenë të vlefshme deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Afati për harmonizimin me ligjin

Neni 84

Shoqëritë tregtare, persona të tjerë juridikë dhe sipërmarrës, të cilët kryejnë prodhim, testim dhe tregti të lëndëve plasëse ose përdorin lëndë plasëse dhe kryejnë ruajtjen e këtyre lëndëve në bazë të lejeve të miratuara me ligjin për tregtinë e lëndëve plasëse ("Fletorja Zyrtare e RFSJ", nr. 30/85, 6/89, 53/91 dhe "Fletorja Zyrtare e RSJ", numër 68/2002) dhe me ligjin "Për lëndët plasëse", lëngjet dhe gazet djegëse ("Službeni list SRCG", nr. 44/76, 49/76, 34/86 dhe 11/88) janë të detyruar që biznesin dhe aktivitetin t'i bashkërendojë me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e këtij ligji në afatin prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Njohja e provimit profesional të dhënë

Neni 85

Provimi profesional i dhënë për kryerjen e veprimeve të minimimit ose shfaqjen e fishekzjarreve publike sipas akteve nënligjore që kanë qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet i dhënë në përmbajtje të këtij ligji.

Procedurat për miratimin e autorizimeve ose lejeve

Neni 86

Procedurat për dhënie leje domethënë lejeve të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë sipas ligjit "Për tregtinë e lëndëve plasëse" ("Fletorja Zyrtare e RFSJ", nr. 30/85, 6/89, 53/91 dhe "Fletorja Zyrtare e RFJ", numër 68/02) dhe ligjit "Për lëndët plasëse, lëngjet dhe gazet djegëse" ("Fletorja Zyrtare e RFSJ", nr. 44/76, 49/76, 34/86 dhe 11/88).

Ndërprerja e vlefshmërisë së ligjit të mëparshëm

Neni 87

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërpritet zbatimi i ligjit "Për tregtinë e lëndëve plasëse" ("Fletorja Zyrtare e RFSJ", nr. 30/85, 6/89, 53/91 dhe "Fletorja Zyrtare e RFJ", nr. 68/02) dhe ndërpret vlefshmëria e ligjit "Për lëndët plasëse, lëngjet dhe gazet djegëse" ("Fletorja Zyrtare e RFSJ", nr. 44/76, 49/76, 34/86 dhe 11/88), në pjesën që lidhet me lëndët plasëse.

Hyrja në fuqi

Neni 88

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga data e publikimit në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi".

SU-SK Broj 01-554/6

Podgoricë, 29 korrik 2008

Kuvendi i Malit të Zi

Kryetari
Ranko Krivokapić, s.r.

Me rikontrollin e kryer me tekstin origjinal, është konstatuar se në tekstin e ligjit “Për lëndët plasëse” të publikuara në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi”, nr. 49/08, është shkurtuar gabimi teknik, dhe paraqitet

Korrigjimi i ligjit “Për lëndët plasëse”

*Korrigjimi është kryer në “Fletoren Zyrtare të MZ”,nr. 58/2008 datë
1.10.2008*

- 1) Në nenin 2 në vend të fjalës së vënë “dhe përdorimin” duhet të jetë fjala “dhe përdorimin”;
- 2) Në nenin 15 në paragrafin 2 në vend të fjalës “bashkërendim i cili” duhet të jetë fjala: “bashkërendimin i cili”;
- 3) Në nenin 30 pas fjalëve “fillimi” duhet të ketë presje;
- 4) Në nenin 41 në paragrafin 3 në vend të fjalëve të vëna “personit përgjegjës” duhet të jetë fjala: “person përgjegjës”;
- 5) Në nenin 79 në paragrafin 1 në vend të fjalëve të vëna “gazetka” duhet të vihen fjalët: “gazetka”;
- 6) Në nenin 80 në paragrafin 1 pas fjalëve “sipërmarrës” duhet të vihet presje.

Nga Shërbimi i Kuvendit të Malit të Zi